

VENDIM
Nr.84, datë 17.7.2008

PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “E-VENTO S.R.L. ALBANIA” SHPK

(Ndryshuar me vendimin nr. 253, datë 21.12.2020¹)

(I përditësuar)

Në mbështetje të neneve 9 dhe 13 pika 1, germa “a”, 8, si dhe 15 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 5, 13, si dhe 14 të “Rregullores për procedurat e licencimit”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.21, datë 4.4.2007, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Sektorit të Energjisë Elektrike (ERE), në mbledhjen e tij të datës 17.7.2008, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “E-Vento s.r.l. Albania” sh.p.k., për t’u licencuar në aktivitetin e ndërtimit, instalimit dhe shfrytëzimit të centraleve elektrike me erë, si dhe prodhimin e energjisë elektrike,

konstatoi se:

1. Fillimi i procedurave për shqyrtimin e aplikimit të “E-Vento s.r.l Albania” sh.p.k., ka nisur me marrjen e vendimit nr.51, datë 9.5.2008.

2. Ligji nr.9913, datë 5.5.2008 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, nuk parashikon të ketë fuqi prapavepruese për aplikimet e paraqitura para hyrjes në fuqi të këtij ligji.

3. Në lidhje me ndërtimin e këtij parku, shoqëria “E-Vento s.r.l Albania” sh.p.k., aplikimin e saj për t’u licencuar në aktivitetin e ndërtimit, instalimit dhe shfrytëzimit të centraleve elektrike me erë dhe prodhimin e energjisë elektrike, e bazon studimin e prefizibilitetit në të dhëna historike të regjistruara të erës, të matura në lartësi të ndryshme nga ato në të cilat do të punojnë gjeneratorët.

4. Ligji për sektorin e energjisë elektrike parashikon në nenin 15 autoritetin e ERE-s për vendosjen e kushteve të çdo licence,

për sa konstatuar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “E-Vento s.r.l Albania” sh.p.k., në aktivitetin e ndërtimit, instalimit dhe shfrytëzimit të centraleve elektrike me erë, si dhe prodhimin e energjisë elektrike prej tyre me kusht zbatimin përveç sa parashikuar në licencën tip të miratuar nga Bordi i Komisionerëve për aktivitetin e ndërtimit dhe prodhimit të energjisë elektrike, edhe të zbatimit të kushteve të mëposhtme:

a) Kryerjen e një studimi fisibiliteti, që kushtëzohet me instalimin e kullave vrojtuese për të eksperimentuar në kushtet reale dhe nxjerrjen e konkluzioneve definitive për projektin e zbatimit. Përcaktimi në këtë studim i kostos së prodhimit të energjisë elektrike. Ky studim të paraqitet në ERE brenda 12 muajve nga data e lëshimit të licencës dhe përpara fillimit të zbatimit të punimeve. Për këtë shoqëria duhet të sjellë grafikun e rishikuar të punimeve.

b) Shoqëria “E-Vento s.r.l Albania” sh.p.k. duhet të paraqesë pranë ERE-s, marrëveshjen e nënshkruar me OST sh.a., përpara fillimit të ndërtimit të objektit, ku të jenë

¹ Shtyrjen me 30 ditë të vendimmarrjes mbi “Kërkesën e shoqërisë ‘E-Vento SRL Albania’ sh.p.k., për zgjatjen e afatit të plotësimit të kushteve të vendimit të licencimit nr. 84, datë 17.7.2008, të ndryshuar.

të specifikuara detyrimet e ndërsjella, që rrjedhin nga Kodi i Transmetimit.

c) Shoqëria “E-Vento s.r.l Albania” sh.p.k., do të respektojë detyrimet e shërbimit publik që do të rrjedhin në zbatim të nenit 25 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar.

d) Koha e zbatimit e të gjithë projektit përfshirë dhe kolaudimin e veprës, duke i'u referuar datës së lëshimit të licencës të jetë 36 muaj.

e) Mospërbushja e pikave të mësipërme në afatet e përcaktuara e bën licencën të pavlefshme.

2. Afati i vlefshmërisë së licencës të jetë 30 vjet.

3. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komsionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S

Bujar Nepravishta